



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar

Buletini Ekonomik Tremujor
Tetor-Dhjetor
2021

Buletini Ekonomik Tremujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë për tremujorin raportues. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë informativ për të gjithë lexuesit. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Zhvillimet në Ekonominë Botërore	5
Sektori Real	7
Rritja Ekonomike.....	7
Inflacioni.....	8
Sektori i Jashtëm	10
Llogaria Rrjedhëse.....	10
Llogaria Financiare	11
Sektori Bankar	11
Regjistri i Bizneseve	12
Financat Publike	12
Të Hyrat.....	13
Shpenzimet	14
Bilanci i përgjithshëm buxhetor.....	15

Përmbledhje Ekzekutive

Tremujori i katërt i vitit 2021 u karakterizua me rimëkëmbje të ngadalshme dhe rritje të inflacionit në nivel global. Edhe pse numri i rasteve me variantin Delta filloj të ulet dhe kufijtë filluan të hapen, shfaqja e variantit Omikron ndikoi që rikuperimi të mos jetë në trendin e shfaqur në tremujorët e mëparshëm. Ngadalësimi i rimëkëmbjes i atribuohet edhe pengesave të mëdha në zinxhirin e furnizimit, gjë e cila u reflektua në ngritje të theksuar të inflacionit pothuajse në të gjitha vendet.

Pas një rritje dyshifrore në dy tremujorët e mëparshëm të 2021-ës, ekonomia e Kosovës gjatë tremujorit të katërt shënoi rritje më të ulët me rreth 6.4% në terma realë, kryesisht si rezultat i efektit bazë. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së eksportit të shërbimeve, për t'u ndjekur nga një rritje më e moderuar e konsumit, dhe rritje më e ulët e investimeve.

Në linjë me ecurinë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, **inflacioni vazhdoi trendin rritës edhe në këtë tremujor,** duke shënuar një rritje mesatare prej 6.4% (v-m-v), me kontribut kryesor të gjeneruar nga kategoria e ushqimeve dhe e transportit.

Deficiti tregtar i mallrave u thellua, duke arritur vlerën prej 1,020.5 milionë Euro, apo rreth 34.4% më shumë se në 2020 TM4. Ky zgjerim i reflektohet rritjes së ndjeshme të importit të mallrave, çka reflekton jo vetëm rritjen e kërkesës agregate por edhe rritjen e ndjeshme të çmimeve të importit. **Ndërkohë, suficiti tregtar i shërbimeve ishte 139.2 milionë Euro, apo 46.3% më shumë se në 2020 TM4,** çka e zbuti disi kontributin negativ të zgjerimit të mëtejshëm të deficitit tregtar të mallrave në llogarinë rrjedhëse.

Remitancat, të cilat përbëjnë komponentin dominues të bilancit të të ardhurave dytësore, **shënuan rritje më të ngadaltë se në tremujorët e mëparshëm të vitit,** kryesisht për shkak të efektit bazë, por edhe për shkak të rikuperimit të ambientit ekonomik dhe normalizimit të situatës pandemike në Kosovë

Si rrjedhojë, **llogaria rrjedhëse në tremujorin e katërt u zgjerua më tej, duke shënuar një deficit prej 392.8 milionë Euro, apo rreth 18.5% e BPV-së.**

Spektori bankar, gjatë këtij tremujori, shënoi performancë të kënaqshme, më një rritje të kredive të reja prej 40.6% në terma vjetorë dhe ulje të raportit të kredive jo-performuese në 2.3%.

Tremujori i katërt i 2021-ës vazhdon të karakterizohet nga **një performancë e kënaqshme e të hyrave buxhetore,** me një rritje vjetore prej 12.9% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2020. Ndërsa, **shpenzimet buxhetore shënuan rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak prej 0.7%.** Si rezultat i këtyre zhvillimeve, **bilanci buxhetor gjatë tremujorit të katërt të vitit u luhat në territor negativ, por në nivel më të ulët se ai i vitit paraardhës.**

Tabela 1: Indikatorët kryesorë makroekonomik të ekonomisë botërore dhe të brendshme

EKONOMIA BOTËRORE	2017	2018	2019	2020	2021 proj.	
Rritja e BPV-së (ndryshimi vjetor në %)	3.8	3.6	2.8	-3.3	5.9	
Vendet e Zhvilluara	2.5	2.3	1.6	-4.7	5.0	
Vendet në Zhvillim	4.8	4.5	3.6	-2.2	6.5	
Vendet Fqinje (<i>mes. e thjeshtë</i>)	2.9	4.2	3.4	-6.1	5.3	
Inflacioni në Ekonominë (ndryshimi vjetor në %)	3.2	3.6	3.5	3.2	4.3	
Vendet e Zhvilluara	1.7	2.0	1.4	0.7	3.1	
Vendet në Zhvillim	4.4	4.9	5.1	5.1	5.7	
Vendet Fqinje (<i>mes. e thjeshtë</i>)	2.2	2.0	1.1	1.1	2.5	
EKONOMIA E BRENDSHME	2019	2020	2021TM1	2021TM2	2021TM3	2021TM4
Rritja reale e GDP-së (v-m-v %)	4.8	-5.3	4.1	16.8	14.5	6.4
Norma e papunësisë (%)	25.7	25.9	25.8	<i>n/a</i>	<i>n/a</i>	<i>n/a</i>
Çmimet (v-m-v %)						
IHÇK	2.7	0.2	0.6	2.1	4.4	6.4
Indeksi i Çmimeve të Importit	2.3	1.9	2.5	7.7	14.7	19.6
Indeksi i Kostos së Ndërtimit	1.0	-0.2	5.3	12.1	15.2	16.0
Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	0.9	-0.6	2.0	3.6	6.9	7.2
Llogaria rrjedhëse (mil. Euro)	-399.5	-472.2	-152.1	-295.1	148.7	-392.8
Tregtia e mallrave X-IM (mil. Euro)	-3,113.6	-2,821.9	-696.6	-870.8	-979.0	-1,120.5
Eksportet e mallrave	383.5	475.0	152.8	191.7	198.6	209.8
Importet e mallrave	3,497.1	3,296.9	849.4	1,062.5	1,177.6	1,230.3
Tregtia e shërbimeve X-IM (mil. Euro)	926.0	391.5	143.5	136.8	662.8	139.2
Eksportet e shërbimeve	1,675.1	994.0	284.3	331.9	975.8	354.2
Importet e shërbimeve	749.1	602.5	140.8	195.1	313.0	214.9
Remitencat (mil. Euro)	851.5	980.0	242.9	311.5	307.3	285.9
Investimet e huaja direkte (mil. Euro)	254.6	345.7	103.8	119.9	163.0	34.3
Financat Publike						
Të hyrat buxhetore (mil. Euro)	1,888.2	1,722.2	454.9	527.6	628.7	572.5
Shpenzimet buxhetore (mil. Euro)	2,070.0	2,207.4	487.5	480.7	496.2	794.2
Borxhi publik (% e BPV-së)	17.6	22.4	21.8	23.2	23.0	23.0
Sektori Bankar						
Stoku i depozitave (mil. Euro)	3,759.9	4,226.2	4,265.1	4,307.9	4,490.0	4,901.8
Norma mesatare e interesit në depozita të reja %	1.5	1.5	1.5	1.3	1.3	1.3
Stoku i kredive (mil. Euro)	3,031.9	3,246.6	3,320.8	3,510.1	3,572.0	3,748.6
Norma mesatare e interesit në kredi të reja, %	6.5	6.2	6.1	6.0	5.9	5.8

Zhvillimet në Ekonominë Botërore

Gjatë tremujorit të katërt të 2021-ës, ekonomia globale vazhdoi trendin e saj drejt rimëkëmbjes, megjithatë nuk ishte në pozitën që pritej bazuar në parashikimet paraprake. Në pjesën e parë të tremujorit të katërt, statistikat tregonin për një ulje të rasteve me Covid-19, ku vdekjet mesatare në botë u ulen në shtatë mijë për ditë gjatë muajit tetor, nga dhjetë mijë sa ishin në gusht. Mirëpo, ky përmirësim u zbeh gjatë muajit nëntor, kur virusi Covid-19 vazhdoi të jetë kërcënim me variantin e ri Omikron duke shkaktuar një valë të re të infektiveve gjë që ndikoi në masa të reja të kufizimit të lëvizjes. Këto kufizime shkaktuan probleme në zinxhirin furnizues, të cilat së bashku me paqëndrueshmërinë e çmimeve të energjisë ndikuan në pasiguri dhe rritje të inflacionit.

Ekonomia e SHBA-së vazhdoi trendin e rikuperimit duke shënuar rritje vjetore të BPV prej 6.9% në tremujorin e katërt. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së lartë të investimeve private dhe konsumit privat (i nxitur kryesisht nga shërbimet). Në anën tjetër, tregu i punës mbeti i shtrënguar kryesisht nga mungesat në ofertë, duke u reflektuar më tej në rritjen e presioneve në paga. Ndërkohë, Kina u karakterizua nga probleme në tregtinë me pakicë për shkak të masave anti-covid që së bashku me problemet në industrinë e shitblerjes së pronave ndikuan që aktiviteti ekonomik të mos jetë si në tremujoret paraardhës. Megjithatë, përkundër këtyre problemeve Kina shënoi rritje pozitive prej 4% në këtë tremujor.


Ngjashëm me SHBA-në edhe në Mbretërinë e Bashkuar, aktiviteti ekonomik vazhdoi të rritet ku në muajin nëntor për herë të parë e kaloi nivelin e para-pandemisë. Kjo ishte si rezultat i momentumit të krijuar në shumicën e sektorëve të industrisë, posaçërisht në sektorin e prodhimit dhe ndërtimit, performanca e të cilëve u rrit pas lehtësimit të qasjes në lëndën e parë. Megjithatë, ky përmirësim u zbeh gjatë muajit dhjetor si pasojë e problemeve të ngjashme në të gjithë botën, përkatësisht përhapja e variantit Omikron dhe rritja e çmimeve. Gjatë këtij tremujori rritja vjetore e BPV-së ishte 6.5% .

Gjithashtu, edhe BPV-ja e Eurozonës shënoi rritje pozitive prej 4.6% në terma vjetorë. Rritjen më të theksuar e kishin Polonia me 7.7%, Hungaria me 7.1%, Italia me 6.4%, dhe Franca me 5.4%. Ndërsa, Gjermania dhe Sllovakia shënuan rritje të ulët prej 1.4% dhe 1.1%, respektivisht.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2021, çmimet ishin shqetësimi kryesor pasi që pothuajse të gjitha vendet përjetuan ngritje të theksuar të inflacionit. Ky inflacion ishte i shtyrë kryesisht nga çmimet e larta të energjisë dhe problemeve në zinxhirin e prodhimit të shkaktuara nga problemet në anën

e ofertës. Në SHBA, inflacioni arriti vlerën 6.7% në tremujorin e katërt 2021, ku në dhjetor arriti vlerën 7.0%, duke shënuar kështu ritmin më të shpejtë të rritjes që nga viti 1982. Ngjashëm, në Eurozonë inflacioni u luhat rreth vlerës 4.6%, në Mbretëri të Bashkuar rreth 4.4%, ndërsa në Kinë rreth 1.8% (v-m-v). Kina shënoi këtë shkallë të inflacionit kryesisht për dy arsye: *i*) Politikat shtetërore që nxiten rritjen e prodhimit të thenxhillit, gjë që ndikoi në ngadalësimin e rritjes së çmimeve të energjisë; dhe *ii*) Banka Qendrore uli rezervat e detyrueshme duke ndihmuar kështu sektorin e paluajtshmerive .

Grafiku 1- : Çmimet në tregjet ndërkombëtare, % v-m-v



Nga vendet në rajon, rritjen më të madhe të BPV-së e pati Sllovenia me 10.4%, pasuar nga Kroacia me 9.7%, kurse inflacioni më i lartë u shënuar në Serbi me 7.3%.

Tabela 2. Aktiviteti ekonomik në vendet e rajonit, 2021TM4

Vendi	2021TM4 BPV-ja reale (v-m-v)	2021TM4 Inflacioni (%)
Shqipëria	5.2%	3.4%
Mali i Zi	8.2%	2.4%
Maqedonia e Veriut	2.3%	4.3%
Serbia	7.0%	7.3%
Bosnia dhe Hercegovina	7.5%	5.3%
Kroacia	9.7%	4.7%
Sllovenia	10.4%	4.2%
Kosova	6.4%	6.4%

Sektori Real

Rritja Ekonomike


Sipas të dhënave më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), **në tremujorin e katërt të 2021-ës ekonomia e Kosovës shënoi rritje me rreth 6.4% (v-m-v) në terma realë dhe me 15.1% (v-m-v) në terma nominalë.**

Kontributi kryesor në rritjen reale të BPV-së ka ardhur nga **konsumi total** me rreth 8.0 p.p apo rritje vjetore prej 8.6% (privat me rreth 9.4% dhe atij publik me 4.5%). Rritja e importit të mallrave të konsumit me rreth 21.9% (v-m-v), rritja e kredive të reja për qëllime të konsumit me 26.9% (v-m-v); dhe rritja në mbledhjen e TVSH-së me 24.4% (v-m-v) mbështesin rritjen e theksuar të konsumit privat në këtë tremujor.

Investimet totale (private dhe publike) shënuan një rritje të lehtë me rreth 0.8% (v-m-v) apo një kontribut prje 0.3 p.p kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve private. Kjo e fundit mbështetet nga rritja e kredive të reja për qëllime të investimit me 75.2% (v-m-v), rritja e importit të mallrave kapitale me 19.9% (v-m-v) dhe ulja e pasigurisë të lidhura me situantën pandemike.

Eksporti neto i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar një kontribut negativ prej 2.6 p.p, gjë e cila ka çuar në një rritje më të ngadaltë të BPV-së në tremujorin e katërt se në tremujorin e mëparshëm. Ky kontribut negativ i atribuohet rritjes më të shpejtë të importit (veçanërisht mallrave) sesa rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 2 Rritja Reale e BPV-së (%) dhe kontribuesit kryesorë (p.p)



Bazuar në BPV-në sipas aktiviteteve ekonomike, në tremujorin e katërt të 2021-ës, sektorët që kanë shënuar kontribut më të madh kanë qenë: sektori i “*Shërbimeve*” me 2.1 p.p, i ndjekur nga sektori i “*Industrisë*” me 1.2 pikë të përqindjes dhe sektori i “*Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkimit*” me 0.1 p.p. Ndërsa, sektori i “*Ndërtimtarisë*” shënoj rënie prej 0.4 p.p.

Inflacioni

Gjatë TM4 2021, indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) shënoi rritje vjetore mesatarisht me rreth 6.4%. . Dinamika mujore e ecurisë të inflacionit ka qenë vazhdimisht rritëse, duke shënuar rritje prej 5.7%, 6.9% dhe 6.7% në muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor, respektivisht.

Nënkategoritë e IÇK-së që treguan rritjen më të lartë ishin:

- Kategoria “përdorimi i pajisjeve të transportit personal” shënoi rritje vjetore prej 25.8% me kontribut prej 2.0 p.p;
- Kategoria “bukë dhe drithëra” shënoi rritje vjetore prej 11.1% me kontribut rreth 1.1 p.p dhe;
- Kategoria “shërbimet telefonike dhe të telefaksit”, shënoi rritje vjetore prej 13.8% me kontribut prej 0.4 p.p.


Tabela 3 Kontributet e kategorive kryesore në inflacionin vjetor

Nën kategoritë kryesore të IÇK (kontributi në pikë përqindje, nëse nuk ceket ndryshe)	2019	2020				2021			
	Mesatarja	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Ushqimi dhe pijet jo-alkoolike	2.1	0.7	1.0	0.5	0.7	0.1	0.0	1.3	2.6
<i>Ushqimi</i>	2.0	0.6	0.8	0.4	0.6	0.1	-0.1	1.2	2.5
<i>prej të cilave: Buka dhe Drithërat</i>	1.1	0.2	0.2	0.3	0.2	0.3	0.2	0.2	1.1
<i>Pemët</i>	-0.1	0.3	0.3	0.0	-0.1	-0.3	-0.3	-0.1	-0.1
<i>Perimet</i>	0.3	-0.4	-0.3	-0.1	0.2	-0.2	0.0	0.5	0.3
Pijet alkoolike dhe duhani	0.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
<i>prej të cilave: Duhani</i>	0.1	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Komunikimi	0.1	0.0	-0.2	0.0	0.2	0.6	0.6	0.6	0.4
Hotele, Restorante, dhe Kafë	0.0	0.1	0.3	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1
Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	0.1	-0.6	-1.4	-1.2	-1.1	-0.3	1.3	1.6	2.0
IÇK (v-m-v, %)	2.7	1.1	0.2	-0.4	-0.1	0.6	2.1	4.3	6.4

Inflacioni bazë¹ në tremujorin e katërt të 2021-ës, i matur duke përjashtuar kategoritë "ushqim dhe pije jo-alkoolike" dhe kategorinë "transporti", shënoi rritje vjetore prej 3.2%; ndërsa kur përjashton vetëm kategorinë “transport”, inflacioni bazë vlerësohet të jetë rreth 4.8%. Të dy matjet për inflacionin bazë në tremujorin e katërt janë më të ulëta se inflacioni total (i cili mesatarisht për këtë tremujor ishte 6.4%). Megjithatë, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit paraprak inflacioni bazë është dukshëm më i lartë (0.7% në 2020TM4).


¹ Inflacioni bazë mat ndryshimin e çmimeve të produkteve të shportës së konsumatorit, duke përjashtuar luhatshmërinë e përkohshme dhe tranzitore, e cila kryesisht karakterizon kategorinë e ushqimeve apo të energjisë.

Grafiku 3 Inflacioni total ndaj inflacionit bazë



Kontributi i komponentit të inflacionit të komponentit të tregtueshëm² në 2021 TM4 është më i madh se ai i inflacionit të patregtueshëm, duke shënuar një kontribut pozitiv prej 5.5 pikë përqindje, ndërsa kontributi i patregtueshëm është 1.1 pikë përqindje.

Grafiku 4 Kontributi i inflacionit të tregtueshëm dhe patregtueshëm



² Inflacioni i tregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që janë të ekspozuara ndaj tregtisë në tregje ndërkombëtare dhe rrjedhimisht çmimet e tyre nuk ndikohen nga zhvillimet në tregun lokal. Ndërsa, inflacioni i patregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që nuk tregtohen në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht ndikohen nga tregu i brendshëm.

Sektori i Jashtëm

Llogaria Rrjedhëse


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, deficitit tregtar i mallrave arriti vlerën prej 1,020.5 milionë Euro duke reflektuar një zgjerim të deficitit prej 34.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

- Importi i mallrave gjatë tremujorit të katërt të 2021-ës shënoi rritje të theksuar vjetore prej 36.3%.. Kontribut më të theksuar në këtë rritje shënuan kategoria e produkteve minerale (8.9 p.p.); Metalet bazë dhe artikuj prej tyre (5.1 p.p.); Makineritë, veglat, pajisjet elektrike, etj (4.1 p.p) dhe Plastika, goma dhe artikuj prej tyre (3.3 p.p.)
- Eksporti i mallrave gjatë tremujorit të katërt 2021 shënoi rritje vjetore prej 45.6%. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga rritja në ecurinë e eksportit të Artikujt tjerë të prodhuar një kontribut pozitiv prej 25.7 p.p, plastika, goma dhe artikujt prej tyre me kontribut prej 5.8 p.p. dhe Produktet minerale me kontribut prej 3.1 p.p.

Suficiti tregtar i shërbimeve për tremujorin e katërt të 2021-ës është 139.2 milionë Euro , ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit 2020 ka qenë rreth 95.2 milionë Euro. .

- Eksporti i shërbimeve për tremujorin e katërt të vitit 2021 ishte 35.4% më i lartë se ai në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me kontributin kryesor pozitiv të ardhur nga eksporti i shërbimeve të udhëtimit me kontribut 23.5 p.p; për t'u ndjekur nga eksporti i shërbimeve të kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit me 6.6 p.p; shërbimet ndërtimit me 2.8 p.p dhe eksporti i shërbimeve të transportit prej 2.0p.p.,
- Importi i shërbimeve ka shënuar rritje vjetore prej 29.2%, kryesisht si rezultat i rritjes së importit të shërbimeve të transportit të cilat kontribuuan me 15.8 p.p; importit të shërbimeve të udhëtimit me kontribut prej 13.9 p.p; Shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit me kontribut prej 1.9 p.p.; dhe Shërbimet pensionale dhe të sigurimit me kontribut prej 1.3 p.p.

Grafiku 5 Llogaria rrjedhëse



Bilanci i të ardhurave parësore për tremujorin e katërt të 2021-ës ka shënuar një rritje vjetore prej 125.6%, duke arritur vlerën 68 milionë Euro.


Bilanci i të ardhurave dytësore për këtë tremujor arriti vlerën prej 420,5 milionë Euro, që është 12% më i ulët se bilanci në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo ulje është

reflektuar në të dy nënkomponentët e bilancit. Duke qenë se bilanci i të ardhurave dytësore dominohet nga hyrjet e remitencave, vlen të ceket se remitencat në këtë tremujor shënuan një rritje të lehtë vjetore prej 1%.

Llogaria rrjedhëse si total në 2021TM4 shënoi deficit në vlerën 392.8 milionë Euro, ndërkohë që në 2020TM4 ishte në deficit në vlerën 156.6 milionë Euro. Ky zgjerim i deficietit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet kryesisht rritjes së deficietit në sektorin e mallrave.

Llogaria Financiare

Grafiku 7 Llogaria Financiare



Bilanci i llogarisë financiare është ulur me rreth 217 milionë Euro në terma vjetorë, kryesisht si rezultat i uljes së theksuar në kategorinë e “investimeve të tjera”.

Gjatë kësaj periudhe, hyrjet totale të IHD-ve shënuan ulje vjetore të theksuar prej 62.5%. Kjo ulje erdhi kryesisht nga ulja e IHD-ve në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me një kontribut negativ prej 88.2 p.p, pasuar nga kategoria e furnizimit me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar me kontribut 37.7 p.p., pastaj kategoria e xehetarisë dhe guroret me 15.2 pp. Kjo ulje është kundërvepruar nga rritja e IHD-ve në sektorin e “aktiviteteve të patundshmërisë” me kontribut 51.4

p.p. dhe “informacion dhe komunikim” me kontribut negativ prej 7.5 p.p.

Sektori Bankar

- Tremujori i katërt i vitit 2021 u karakterizua me rritje të kredive të reja prej 40.6%, krahasuar me 2020 TM4. Kjo rritje u reflektua tek kreditë e korporatave jo-financiare me rreth 48.0% dhe tek kreditë e ekonomive familjare me 28.3% krahasuar me vitin e kaluar.
- Depozitat e reja në tremujorin e katërt të këtij viti, shënuan ulje vjetore prej 17.1%. Kjo ulje u ndikua nga ulja vjetore në depozitat e korporatave jo-financiare prej 36.1%, dhe ulja në depozitat e reja të ekonomive familjare prej 5.6%.
- Norma efektive e interesit për kreditë e reja për tremujorin e katërt të vitit 2021 ishte mesatarisht 5.8%, ndërsa ajo për depozitat e reja ishte mesatarisht 1.2%.

- Kreditë jo-performuese gjatë tremujorit të katërt ishin 2.3% e totalit të kredive, duke treguar një përmirësim nga ecuria e tremujorëve të mëparshëm.

Tabela 4 Indikatorët e Sektorit Financiar

	2019				2020				2021			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Depozitat e reja % Δ	0.8	22.6	-0.1	-5.9	-5.3	-40.4	-25.0	-13.6	-5.59	6.53	0.76	-17.1
Kreditë e reja % Δ	-5.0	1.8	26.1	1.5	28.4	-47.8	30.3	5.7	-10.1	136.3	-14.3	40.6
Norma efektive e interesit në kredi të reja	6.7	6.4	6.4	6.4	6.4	6.2	6.2	6.1	6.1	6.0	5.92	5.8
Norma efektive e interesit në depozita të reja	1.5	1.4	1.4	1.5	1.5	1.5	1.4	1.6	1.5	1.3	1.31	1.2
Kreditë jo-performuese	2.6	2.6	2.3	2.1	2.4	2.6	2.6	2.7	2.7	3.2	2.5	2.3

Regjistri i Bizneseve

- Në tremujorin e katërt të vitit 2021 (TM4) gjithsej janë regjistruar 2,416 ndërmarrje. Kjo reflekton një rënie prej 2.5% krahasuar me tremujorin paraprak, dhe një rënie prej 15.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (TM4 2020).
- Prej tyre:
 - 646 biznese të reja në tregtinë me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave (82 më pak se në 2020 TM4)
 - 183 biznese të reja në sektorin e ndërtimit (85 më pak se në 2020 TM4)
 - 296 biznese të reja në sektorin e prodhimit (58 më pak se në 2020 TM4)
 - 251 biznese të reja në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve me ushqim (24 më pak se në 2020 TM4)
- Struktura e bizneseve të reja gjatë 2021 TM4 dominohet nga ndërmarrjet mikro (2,371 ndërmarrje), për t'u ndjekur nga ndërmarrje të vogla (37), ndërmarrje të mesme (7), dhe një ndërmarrje e madhe (1).
- Pjesa dërrmuese janë me kapital vendor (2,404 ndërmarrje) dhe vetëm 12 prej tyre janë me kapital të huaj dhe të përbashkët.
- Numri i bizneseve të shuara gjatë 2021 TM4 arriti në 494. Ndërmarrjet e shuara gjatë këtij tremujori kanë qenë kryesisht nga sektori i tregtisë, akomodimit, transportit dhe prodhimit.

Financat Publike

Duke marrë parasysh faktin se viti 2020 ka qenë i përcjellur me mbyllje të ekonomisë për shkak të pandemisë COVID-19, vlerësimi i performancës së treguesve fiskalë do të bëhet në krahasim jo vetëm me tremujorin e katërt të vitit 2020, por dhe me atë të vitit 2019, për të dalluar më mirë efektin bazë nga efektet e përshpejtimit të aktivitetit ekonomik, masat e ndërmarra në kuadër të


formalizimit, apo të dinamikës së ekzekutimit të masave të ndërmarra në kuadër të menaxhimit të pandemisë Covid-19.

Të Hyrat

Të hyrat buxhetore gjatë tremujorit të katërt të 2021-ës shënuan vlerën 572.5 milionë Euro, duke shënuar rritje vjetore prej 12.9%, përkatësisht.

- **Të hyrat tatimore** për këtë periudhë shënuan vlerën 508.6 milionë Euro, rritje prej 18.8% dhe 15.6% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2020 dhe 2019, respektivisht.
- **Të hyrat direkte** arritën vlerën 84.1 milionë Euro, duke qëndruar 15.8% dhe 16.3% më lartë se periudha e njëjtë e vitit 2020 dhe 2019, përkatësisht. Prej tyre:
 - Të hyrat nga Tatimi në të Ardhura të Korporatave arritën 27.3 milionë (33.2% dhe 24.6% më shumë se TM4 2020 dhe TM4 2019, përkatësisht).
 - Të hyrat nga Tatimi në të Ardhurat Personale arritën 49.5 milionë Euro (12.1% dhe 15.4% më shumë krahasuar me TM4 2020 dhe TM4 2019, përkatësisht).
 - Ndërsa të hyrat nga Tatimi në Pronë arritën vlerën prej 6.5 milionë (14.3% më pak dhe 6.3% më shumë krahasuar me TM4 2020 dhe TM4 2019, përkatësisht).
- **Të hyrat indirekte**, që njëkohësisht janë edhe kontribuuesit kryesorë në të hyrat totale buxhetore, në tremujorin e katërt të 2021-ës janë rritur për 21.6% dhe 17.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 dhe 2019, respektivisht, duke arritur vlerën 447.7 milionë Euro. Ecuria e të hyrave indirekte është në linjë me ecurinë e importeve të mallrave, i cili shënoi rritje prej 34.28% dhe 39.29% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2020 dhe 2019, respektivisht, jo vetëm si rezultat i rritjes së kërkesës agregate por edhe rritjes së theksuar së çmimeve të importit gjatë kësaj periudhe.
 - Të hyrat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar shënuan rritje prej 24.4% krahasuar me TM4 2020 dhe 22.7% krahasuar me TM4 2019.
 - Të hyrat nga akciza shënuan rritje prej 17.7% krahasuar me TM4 2020 dhe 14.1% krahasuar me TM4 2019.
 - Detyrimi doganor shënoi rritje prej 18.0% krahasuar me 2020 TM4 për shkak të rritjes së importit të mallrave (efekti bazë), mirëpo krahasuar me 2019 TM4, ka shënuar rënie prej 1.1%, kryesisht si rezultat i efektit të MTL-së me Turqinë dhe efektit të MSA-së.
- **Të hyrat jo-tatimore** për këtë periudhë ishin rreth 63.9 milionë Euro, me një rritje vjetore prej 16.6% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si dhe një rënie vjetore prej 11.6% në krahasim me TM4 2019.


Grafiku 8. Performanca e të hyrave buxhetore gjatë tremujorit të katërt (2019, 2020 dhe 2021)



Shpenzimet

- **Shpenzimet buxhetore** për tremujorin e katërt të 2021-tës arritën vlerën prej 794.2 milionë Euro dhe ishin rreth 0.7% më të larta se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar, dhe 9.7% më të larta se periudha e njëjtë e vitit 2019.
 - **Kategoria e shpenzimeve rrjedhëse** në tremujorin e katërt të vitit 2021, arriti vlerën prej 595.2 milionë Euro dhe kjo paraqet një rënie prej 2.9% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si rrjedhojë e dinamikës më të ulët të shpenzimeve që lidhen me menaxhimin e pandemisë. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2019 (vit në të cilin nuk ka pasur shpenzime të lidhura me pandeminë), shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 31.5%.
 - **Kategoria e pagave** arriti vlerën prej 166.8 milionë Euro dhe paraqet një rënie prej 2.1% (v-m-v); *mallrat dhe shërbimet* arritën vlerën 126.5 milionë euro, e cila vlerë në krahasim me tremujorin njëjtë të vitit të kaluar paraqet rritje prej 4.7% (v-m-v); ndërsa, kategoria e *subvencioneve dhe transfereve* arriti vlerën prej 301.8 milionë Euro, e cila është 6.3% më e ulët se sa periudha e njëjtë e vitit paraprak.
 - **Shpenzimet kapitale** arritën vlerën prej 199.0 milionë Euro dhe paraqesin rritje prej 13.4% me periudhën krahasuese të 2020.
 - **Interesi** arriti vlerën prej 8.0 milionë Euro për tremujorin e katërt të vitit 2021.

Grafiku 9. Performanca e shpenzimeve buxhetore gjatë tremujorit të dytë (2019, 2020 dhe 2021)



Bilanci i përgjithshëm buxhetor

- **Bilanci i përgjithshëm buxhetor (kumulativ)** në fund të tremujorit të katërt arriti në deficit prej 107.1 milionë Euro.
- Ndërsa **vetëm për periudhën tetor-dhjetor**, bilanci i përgjithshëm buxhetor luhatej në territor negativ, rreth 229.7 milionë Euro.

Grafiku 10. Bilanci i përgjithshëm buxhetor (2019, 2020 dhe 2021)

